



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**INSPEKTORATI I LARTË I DEKLARIMIT DHE KONTROLLIT TË
PASURIVE DHE KONFLIKTIT TË INTERESAVE
INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM**

Nr. 850 Prot.

Tiranë, më 9/3/2015

URDHËR

Nr 41, datë 9.3.2015

PËR

“MIRATIMIN E PROGRAMIT TË TRANSPARENCËS TË ILDKPKI”

Në zbatim të neneve 4, 5, 6, 7, 19 të ligjit nr. 119, datë 18.9.2014 “Për të drejtën e informimit” (LDI) dhe pikës 2 të nenit 42 të ligjit nr. 9367, datë 7.4.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, i ndryshuar;

URDHËROJ:

1. Miratimin e Programit të Transparencës së Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave, bashkëlidhur këtij urdhëri. (përkatësisht shtojca A).
2. Përditësimin e Programit të Transparencës, në përputhje me nenin 4 dhe pikën 2 të nenit 19 të LDI-së, me qëllim:
 - a. garantimin e njohjes maksimale me informacionin publik;
 - b. vënien në dispozicion pa kërkesë të sa më shumë informacioneve, në mënyrë që të pakësohet nevoja për kërkesa individuale për informacion;
 - c. modelet e miratuara për kategorinë e autoritetit publik nga Komisioneri për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, sipas nenit 6 të këtij ligji.
3. Publikimin e Programit të Transparencës në faqen zyrtare të internetit të ILDKPKI-së: www.hidaa.gov.al, në një menu të veçantë të titulluar “Programi i Transparencës” dhe në mjediset e pritjes së publikut.

4. Delegimin e kompetencave, të parashikuara në pikën 2 të nenit 19 të LDI-së, Sekretarit të Përgjithshëm si nëpunësi më i lartë civil i ILDKPKI-së, si mëposhtë vijon:
- a. Zbatimin e Programit të Transparencës të miratuar ku përcaktohen kategoritë e informacionit që bëhet publik pa kërkesë dhe mënyra e bërjes publike të këtij informacioni.
 - b. Rishikimin e Programit të Transparencës një herë në 4 vjet, në përputhje me pikën 2 të nenit 5 të LDI-së, përmes të njëjtës procedurë që është bërë dhe miratimi i tij.
 - a. Dhënie e informacionit në formë shkresore apo në rrugë elektronike pa pagesë:
 - Në rastet kur vlerësohet se dhënia e informacionit do të kryhet kundrejt pagesës, tarifa do të përcaktohet më parë dhe do të bëhet publike nga ILDKPKI-ja në faqen e saj të internetit dhe në mjediset e pritjes së publikut. Tarifa është kostoja e riprodhimit të informacionit të kërkuar dhe, kur është rasti, e dërgimit të tij.
 - Kostoja e riprodhimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja reale e materialit, mbi të cilin riprodhohet informacioni. Kostoja e dërgimit nuk mund të jetë më e lartë se kostoja mesatare e të njëjtit shërbim në treg.
5. Ngarkohet për zbatimin e këtij urdhëri Sekretari i Përgjithshëm.
6. Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

INSPEKTORI I PËRGJITHSHËM

Shkëlqim GANAJ

